



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

Datë: 08.08.2023

Ref. KM-270/23

Në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 8, 9, 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 1.4) neni 15, Shtojca 11 të Rregullores (QRK)-Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (30.03.2021), dhe Nenin 20 (paragrafët 1, 4 dhe 5) të Ligjit Nr. 03/L-042 i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve, (Gazeta Zyrtare Nr. 44, datë 22.12.2008) si dhe në bazë të rekomandimit të Komisionit për vlerësim dhe autorizim të Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve, me Ref.04-382/23, të datës 31.07.2023, Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, nxjerrë:

VENDIM

Për futjen në regjistër dhe lejimin e autorizimit të produktit për mbrojtjen e bimëve për përdorim

1. Lejohet importimi, vendosja në treg dhe përdorimi i autorizimit të produktit për mbrojtjen e bimëve – Acorix 70 WG i prodhuesit “Globachem NV”, Belgjika nga përfaqësuesi i saj “Agronomi Group” SH.P.K, Suharekë.

2. LLOJI I PRODUKTIT: Herbicid

3. PËRMBAJTJA E SUBSTANCËS AKTIVE: Metribuzin.....700g/kg

4. PËRDORIMI:

Acorix 70 WG është një herbicid selektive që përmban metribuzin. Ky përbërës aktiv bën pjesë në familjen e triazinonit dhe punon duke penguar fotosintezën pas thithjes nga rrënjët dhe gjethet e barojave të këqija. Ajo është e efektshme kryesisht në barojat e këqija me gjethet të gjera dhe disa gjethet të ngushta.

Patatet dhe patatet e farës, kundër barërave vjetore (Poaceae (vjetore)) dhe barërave të gjera vjetore (Dicotyledoneae (vjetore)).

Max. 1 aplikim/kulturë – max. 525g metribuzin/ha/36 muaj.

Doza: 0.75kg/ha, 1 aplikim.

Faza aplikimit: para – mbirjes (BBCH 01-08).

Masat e rekomandimit të rrezikut: zona tampon 20 m me teknikë që redukton spërkatjen 90%.

Kundër domates se zeze(Solanum nigrum) dhe ngjitësit (Galium aparine)

Max. 1 aplikim/kulturë – max. 525g metribuzin/ha/36 muaj.

Doza: 0.625g/ha, te përziëra me produkt clomazone, 1 aplikim ose 0.5 kg/ha te përziëra me produkte prosulocarb, 1 aplikim

Faza aplikimit: para – mbirjes (BBCH 01-08).

Masat e rekomandimit të rrezikut: zona tampon 20 m me teknikë që redukton spërkatjen 90%.

Kundër barërave vjetore (poaceae (vjetore) dhe barërave të gjëra vjetore (Dicotyledoneae (vjetore)).

Max. 1 aplikim/kulturë – max. 525g metribuzin/ha/36 muaj.

Doza: 0.5kg/ha, 1 aplikim.

Faza e aplikimit: dalja – 5 gjethe (BBCH 09-15).

Masat e reduktimit të rrezikut zona tampon 20 m me teknikë që redukton spërkatjen 90%.

5. SASIA E AMBALAZHIMIT PËR IMPORTIM:

100, 250 dhe 500g, 1.0, 2, 3, 4, 5 kg.

6. VËREJTJE:

Doza e autorizuar është doza më e vogël që garanton efikasitet më të mirë në shumicën e situatave. Ajo mund të reduktohet nën përgjegjësinë e përdoruesit. Reduktimi i dozës së aplikuar nuk lejon rritjen e numrit maksimal të aplikimeve dhe as reduktimin e kohës së pritjes (s).

7. KARENCA:

Nuk ka.



GHS08-i dëmshëm për shëndeti

8. PROPOZIMI I KLASIFIKIMIT:



GHS09-paralajmërim i rrezikshëm për ambient

9. VENDI I SHITJËS: Në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

10. Produkti për mbrojtjen e bimëve i autorizuar nga pika 1 e këtij vendimi lejohe të importohet në Republikën e Kosovës, deri në afatin siç është përcaktuar në certifikatën e regjistrimit, duke u bazuar në Databazën e Pesticideve të BE-se/Substancave aktive, ndërsa qarkullimi dhe përdorimi i tij lejohe sipas nenit 26 paragrafi 3 i Ligjit Nr.03/L-042 i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve.



Faton Peci

Ministër

Vendimi i dërgohet:

- *Komisioni për vlerësimin dhe autorizimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve;*
- *Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregjeve;*
- *Shërbimi kufitar fitosanitar;*
- *Inspektorët fitosanitar AUV;*
- *Importuesit të produkteve për mbrojtjen e bimëve;*
- *Arkivit.*